

VENDIM
Nr.14, datë 15.10.2004

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 18.3.2004, 29.3.2004 dhe 29.4.2004, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.10 Akti që i përket:

KËRKUES: INSTITUTI I SIGURIMEVE SH.A, përfaqësuar nga avokatët Vangjel Kosta e Kostandin Trëndafili, me autorizim.

SUBJEKT I INTERESUAR: TATJANA MEHMETAJ, përfaqësuar nga avokat Eduart Halimi, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr.3103, datë 11.7.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.276, datë 4.3.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1929, datë 16.12.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit);

- Pezullimin e zbatimit të vendimeve të mësipërme.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f, 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenet 27, 28, 29, 30 e 45 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Kërkuesi ka parashtruar se:

- Janë shkelur dispozitat procedurale që lidhen me juridiksionin. Republika e Shqipërisë që në vitin 1992 ka aderuar në Këshillin e Byrove të Sigurimit. Me nënshkrimin e Marrëveshjes Tip midis Byrove, ato janë përgjegjëse për drejtimin dhe funksionimin e Sistemit të Kartanit Jeshil, prandaj gjykatat nuk duhej të shqyrtonin një padi të tillë sepse ishte jashtë juridiksionit të tyre;

- Nuk janë respektuar dispozitat për mënyrën e marrjes së provave. Në kundërshtim me nenin 266 të Kodit të Procedurës Civile, shkresat e përpiluara në gjuhën turke nuk janë shoqëruar me përkthimin e tyre në gjuhën shqipe dhe nuk janë të legalizuara nga organi përkatës kompetent. Legalizimi i dokumentave është garanci për vlerën autentike të dokumenteve;

- Janë shkelur rregullat procedurale lidhur me cilësinë e ekspertit, si një nga provat e procesit. Në kundërshtim me kërkesat e nenit 224 shkronja “a” të Kodit të Procedurës Civile, gjykatat kanë pranuar si të tillë një person që nuk ka njohuri të posaçme në fushën përkatëse;

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ka vendosur mospranimin e rekursit, në dhomën e këshillimit, Dhe ka mohuar kështu të drejtën e mbrojtjes, si një element shumë i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor. Në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë janë parashtruar shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile. Shkaku kryesor i parashtruar në rekurs ka qenë mungesa e juridiksionit për shqyrtimin e çështjes nga gjykata shqiptare, prandaj mospranimi i rekursit i ka hequr mundësinë kërkuesit të dëgjohet në seancë plenare prej Gjykatës Lartë për shkaqet e parashtruara.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi relatorin e çështjes, kryetarin, Gjergj Sauli, përfaqësuesit e palës kërkuese, të subjektit të interesuar si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Sikurse rezulton nga dosja gjyqësore, në datën 1.8.1999, në afërsi të qytetit të Stambollit, subjekti i interesuar, është aksidentuar duke dëmtuar rëndë shëndetin si rrjedhojë e rrëzimit të automjetit në të cilin ndodhej dhe që drejtohej nga shtetasi shqiptar Besim Mehmetaj.

Drejtuuesi i automjetit ka qenë i pajisur me policën e sigurimit TPL (përgjegjësia e detyrueshme e mbajtësve të mjeteve motorrike ndaj palëve të treta), si dhe me Çertifikatën Ndërkombëtare të Sigurimit, Kartonin Jeshil me vlefshmëri nga data 29.4.1999 deri më 28.10.1999. Para se të bënte padi për dëmshpërblim, Tatjana Mehmetaj, me rekomandimin e INSIG Sha., i është drejtuar Byrosë Turke të Sigurimit dhe është dëmshpërblyer prej saj me shumën 3 miliard lira turke.

Subjekti i interesuar, duke pretenduar se shpenzimet e kryera për mjekimin ishin më të mëdha, nuk e ka pranuar këtë dëmshpërblim dhe i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr.3103, datë 11.7.2002, ka pranuar padinë duke detyruar INSIG Sha., ta dëmshpërblejë atë në shumën prej 20 milion lekë. Mbi ankimin e INSIG Sha., Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.276, datë 4.3.2003, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit), me vendimin nr.1929, datë 16.12.2003, ka vendosur mospranimin e rekursit.

Gjykata Kushtetuese, duke analizuar shkaqet e parashtruara në kërkesë, arrin në përfundimin se, ndërmjet tyre, kryesoret janë shkaqet që lidhen me problemin e juridiksionit dhe të gjykatës kompetente për shqyrtimin e padive të shpërblimit të dëmeve si rrjedhojë e aksidenteve të shkaktuara nga përdoruesit e mjeteve motorrike të pajisur me karton jeshil.

Gjykata e Lartë, duke e shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, nuk është shprehur me vendim të seancës gjyqësore për bazueshmërinë e vendimeve të gjykatave të rrethit dhe të apelit lidhur me juridiksionin dhe gjykatën kompetente. Në këto kushte, nuk mund të pranohet kërkesa për shfuqizimin e këtyre vendimeve nga Gjykata Kushtetuese sepse kjo do të ndikonte drejtpërdrejt në zgjidhjen në themel të çështjes në rastin e rigjykimit të saj.

Nga tërësia e materialeve të çështjes dhe nga vetë përmbajtja e rekursit drejtuar Gjykatës së Lartë, rezulton se ekzistojnë dhe janë ngritur disa probleme me karakter ligjor, që së bashku me veçantinë që paraqet rasti konkret në lidhje me rregullat e juridiksionit dhe të kompetencës përbënin arsye që dhoma e këshillimit të vendoste kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.

Konkluzionin e mësipërm e bazojmë në qëndrimet e palëve në të gjitha instancat gjyqësore ku bëhet evident konflikti që ekziston lidhur me juridiksionin e gjykatës shqiptare dhe të gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për dëmshpërblimin. Ndërsa subjekti i interesuar ka insistuar se padia duhej zgjidhur nga gjykata shqiptare, kërkuesi ka pretenduar se duhej zbatuar rasti përjashtimor i parashikuar nga neni 37, paragrafi i dytë, i Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit, për këtë kategori çështjesh, kompetente është gjykata e vendit të shtetit ku ka ndodhur aksidenti. Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se në bazë të nenit 59 të Kodit të Procedurës Civile, kundërshtimet për juridiksionin dhe kompetencën parashtrihen në Gjykatën e Lartë, si gjykatë e shkallës së dytë dhe se, në frymën e kësaj dispozite, dhoma e këshillimit të Kolegjit Civil, duhej të vendoste kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.

Në rastin konkret kemi të bëjmë me një çështje që kërkon zgjidhje nga Gjykata e Lartë në seancë gjyqësore, sepse, problemet ligjore të përmendura më lart si dhe shkeljet procedurale të pretenduara në rekurs, të bazuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile, kërkonin përgjigje të arsyetuar me vendim të Gjykatës së Lartë, pavarësisht nëse do të ishin në favor ose jo të palës që ka ushtruar rekursin.

Gjykata Kushtetuese vuri në bisedim edhe kërkimet apo pretendimet e tjera të parashtruara nga kërkuesi para dhe gjatë gjykimit të çështjes dhe arriti në përfundimin, se ato janë të pabazuara. Gjykata Kushtetuese, duke u bazuar në kuptimin e nenit 16, paragrafi i dytë si dhe në nenet 131/f e 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, konkludoi se, kërkuesi INSIG Sha., legjitimohet të verë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, duke rrëzuar kështu edhe pretendimin për të kundërtën, parashtruar nga përfaqësuesi i subjektit të interesuar.

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 131 shkronja “f” të

Kushtetutës, si dhe nenet 72 e 77 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr.1929, datë 16.12.2003, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit).
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.